VENDIM
Nr. 44, datë 23.1.2013

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 934, DATË 26.12.2012 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE ME KONTRATË TË PËRKOHSHME, PËR VITIN 2013, NË NJËSITË E QEVERISJES QENDRORE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2 të nenit 18 të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë" dhe të nenit 11 të ligjit nr. 119/2012 "Për buxhetin e vitit 2013", me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 934, datë 26.12.2012 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

a) Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"1. Numri i punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2013, në njësitë e qeverisjes qendrore, bëhet 932 punonjës. Shtesa prej 242 punonjësish është dhënë me hollësi sipas lidhjes nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.".

b) Në lidhjen nr. 1, bashkëlidhur vendimit, bëhen këto ndryshime:

- Emërtesat "specialist" dhe "ndihmësspecialist" për Drejtorinë e Përgjithshme të ALUIZNI-t dhe drejtoritë e tjera të ALUIZNI-t zëvendësohen me"specialist/ndihmësspecialist".
- Emërtesa "mirëmbajtës" në Autoritetin e Konkurrencës zëvendësohet me "specialist protokolli".
- Hiqet nga lidhja numri i punonjësve të Avokatit të Prokurimeve.
- Reduktohet me 2 (dy) vetë numri i punonjësve për Qendrën e Transferimit të Teknologjisë Bujqësore Korçë dhe shtohet me 2 (dy) vetë numri i punonjësve në Agjencinë Kombëtare të Duhan-Cigareve.

2. Efektet financiare për zbatimin e këtij vendimi për SHISH-in përballohen nga shpenzimet korente, të miratuara në buxhetin përkatës të vitit 2013, ndërsa për ALUIZNI-n, të përballohen nga të ardhurat e vetë institucionit.

3. Ngarkohen ministritë dhe institucionet buxhetore sipas lidhjes nr. 1, të përmendur në pikën 1, të depozitojë pranë Ministrisë së Financave detajimin e numrit të punonjësve në përputhje me kriteret e përcaktuara në vendimin nr. 1703, datë 24.12.2008 të Këshillit të Ministrave "Për vendosjen e standardeve të shërbimeve dhe aktiviteteve sezonale/të përkohshme për ministritë dhe institucionet buxhetore".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha